VENDIM
Nr. 3, datë 11.1.2013

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES DHE EMËRIMIT TË ADMINISTRATORIT, NË ZBATIM TË VENDIMIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 158, DATË 16 NËNTOR 2012 "PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCAVE PËR AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES DHE AKTIVITETIT TË FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË"

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 18 pika 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 13 të rregullores "Për procedurat e heqjes së një licence", miratuar me vendimin nr. 68, datë 4.11.2005 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 158, datë 16 nëntor 2012 "Për fillimin e procedurave për heqjen e licencave shoqërisë "CEZ Shpërndarje", për aktivitetin e shpërndarjes dhe të aktivitetit të furnizimit publik me pakicë", nenit 4 të rregullores "Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij", miratuar me vendimin nr. 1, datë 10.1.2013, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.1.2013, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes së administratorit potencial të shoqërisë "CEZ Shpërndarje", emërimi i të cilit do të bëhet efektiv në rast të marrjes së vendimit përfundimtar për heqjen e licencës shoqërisë së interesuar, nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të përgatitë të gjitha procedurat në lidhje me zbatimin e këtij vendimi të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani